

DPK/DMP

03-4410/12

02

07.12.2012

GJLnr.1251/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.24123/2012, të dt.12.10.2012, e në bazë të neneve 31 al.3, 39 dhe 220 të Ligjit për kundërvajtje, me dt. 08.11.2012 nxjerr:

AKTVENDIM

REFUZOHET ankesa e paraqitur si e pabazuar.
VËRTETOHET aktvendimi i goditur si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.
Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.24123/2012, të 12.10.2012, të pandehurën Nora Qerkezi, nga Prishtina, e ka shpallur përgjegjëse sepse si U.D.-së Menaxhere për buxhet dhe financa në Prokurorin e Shtetit të Kosovës, nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e paraparë ligjor, për vitin 2011 edhe pse ka qenë e njoftuar me kohë për këtë obligim ligjor është vonuar deri me datën 20.04.2012, kur edhe e ka bërë deklarinimin e pasurisë, me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 par. 1 dhe 2 neni 8 par. 1.2 të sanksionuar me nenin 17 par. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, me nr. 04/L-050, e për të cilën kundërvajtje, konform nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet i shqiptoi QORTIM.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur Agjencia Kundër Korrupsionit për shkak të vendimit mbi dënim dhe më tutje në arsyetim të ankesës ndër të tjera theksohet: se me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë e pandehura është dënuar me qortim, se gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur parasysh nga se kjo vepër përkon me një përgjegjësi të latë siç është deklarimi i pasurisë nga Zyrtarët e Lartë Publik, se Gjykata e shkallës së parë nuk ka shqiptuar dënimin meritator sipas ligjit 04/L-050 por të njëjtin e ka zbutur në masë të madhe në kundërshtim me rregullat e përgjithshme mbi zbutjen e dënimit, të përcaktuar sipas nenit 9 të LMK-së.

Kolegji duke i vlerësuar thëniet në ankesën e parashtuar, aktvendimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur është e pabazë, ashtu që aktvendimi i goditur vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kundërvajtës, në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të deklaratës së të pandehurës si dhe shkresave tjera të lëndës dhe nuk ka bërë shkelje të dispozitave kundërvajtjese, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kurse masa e shqiptuar qortim të pandehurës Nora Qerkezi, konsiderohet se është përcaktuar sipas shkallës së

2.

përgjegjësisë, peshës së veprës së kryer si dhe rrethanave nën të cilat është kryer kundërvajtja. Gjykata e shkallës së parë me bazë i ka marrë si të bazuara rrethanat lehtësuese ndaj saj, ndërsa Kolegji vlerëson po ashtu si rrethanë veçanërisht lehtësuese faktin se e pandehura para se të iniciohet procedura kundërvajtëse ndaj saj me datë 15.06.2012, në bazë të kërkesës së AKK-s, e njëjta e ka përmbushur obligimin e përcaktuar, ka bërë deklarin e rregullt të pasurisë me datë 20.04.2012. dhe ky fakt merret si rrethanë se e pandehura është vendosur me kohë kështu që Kolegji vlerëson se edhe pa dhënien e dënimit e njëjta pritet që në të ardhmen nuk do të përsërisë kundërvajtje të këtillë apo të ngjashme, andaj nga këto shkaqe nuk ka bazë dhe argumente të justifikueshme për ndryshimin apo abrogimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Nga të lartcekurat e konform nenit 220 u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË


GJL. nr.1251/2012, datë. 08.11.2012.

SEK. JURIDIKE

Ganimete Dumani

KRYETARI I KOLEGJIT

Ragip Namani



Ragip Namani